

Konsorciumi Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm

(KOSID)

Efiçienca për Zhvillim: Ekonomiksi i Efiçencës së Energjisë në Kosovë

Prishtinë, Maj 2014



KOSID

KOSOVO CIVIL SOCIETY CONSORTIUM FOR
SUSTAINABLE DEVELOPMENT

KONSORCIUMI KOSOVAR I SHOQËRISË CIVILE PËR
ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

Botuar nga INDEP në kuadër të KOSID

Përgatitur nga:

Jetëmira Berisha

Edituar nga:

Shkamb Qavdarbasha

Copyright © 2014 INDEP

Qëllimi dhe struktura e studimit	3
1. Të kuptuarit e mungesës së masave të eficientës së energjisë në Kosovë.....	4
1.1. Fakte dhe shifra rreth Kosovës.....	4
1.2. Konsumi i koeficientit të energjisë në Kosovë.....	5
1.3. Rritja e eficientës, çfarë kërkon ajo?	9
2. Benefitet e eficientës së energjisë.....	10
2.1. Eficientia e energjisë si investim në rritjen ekonomike	10
2.2. Punëzënia si benefit socioekonomik	11
2.3. Efektet në standardin e jetës	12
3. Plani për implementimin e eficientës së energjisë.....	12
3.1. Fuqizimi i vetëdijes qytetare.....	12
3.2. Si mund të ndihmojmë qytetarët të bëjnë shtëpitë e tyre më eficiente ndaj përdorimit të energjisë.....	13
3.2.1. Lehtësirat financiare për eficientën e energjisë	14
3.2.2. Opcionet për parandalimin e sjelljes së dështuar konsumatore	15
Përfundime	16

Qëllimi dhe struktura e studimit

Kosova si vend në tranzicion, po përballet me kërkesë gjithnjë në rritje të burimeve energjetike e kjo vë pjesërisht si pasojë e nivelit të ulët të efijencës, shkallës enorme të humbjeve e vjedhjeve të energjisë dhe pozicionit të padëshiruar përballë tranzicionit ekologjik. Tani në kohën kur kemi targetuar integrimin në Bashkimin Evropian (BE), Kosova qëndron kryesisht pasive me bindjen e plotë se partnerët ndërkombëtarë po hartojnë plane zhvillimore e gjithë ajo çfarë mbetet është dakordimi, financimi dhe implementimi i këtyre planeve apo projekteve. Si e tillë, qeveria e Kosovës ka ngecur dukshëm në përmbushjen e standardeve të përcaktuara nga BE dhe me zhvillimet e fundit duke monopolizuar shpërndarësin e energjisë, ka krijuar një situatë të padëshiruar dhe shumë kaotike e cila kërcënon në mënyrë direkte mirëqenien e çdo qytetari, e sidomos të atyre që janë ndikuar nga varfëria e skajshme tanimë.

Privatizimi apo thënë më vrazhdë monopolizimi i shpërndarësit të energjisë si dhe liberalizimi i tregut që del si obligim nga Traktati i Komunitetit të Energjisë do të bëjnë që qytetarët e Kosovës të paguajnë gjatë viteve në vijim shumëfishin e faturës së sotme. Pra rritja e çmimit të energjisë elektrike është e pashmangshme vetëm se nuk mund të parashihet saktë se kur dhe sa do të jetë ajo. Në anën tjetër, duke pasur parasysh faktin se tregjet në vendet e tranzicionit siç është edhe rasti i Kosovës janë gjithnjë joefijente, çmimi i energjisë mbetet mister duke bartur me vete rrezikun se norma e rritjes mund edhe të tejkaloj lehtësisht pritjet qytetare dhe të shpie kështu vendin në destabilitet politik e ekonomik njëkohësisht.

Kërkesën gjithnjë në rritje të energjisë nga ekonomitë familjare kur aktiviteti ekonomik është relativisht stagnant duhet parë si fakt kërcënues dhe tregues të qartë se masat ekzistuese të efijencës nuk janë duke funksionuar në Kosovë. Përveç kërkesës në rritje, një studim i bërë nga Konsorciumi Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID)¹ ka vënë në pah ekzistencën e theksuar të sezonalitetit, ku energjia elektrike shpenzohet dy herë më shumë gjatë dimrit në krahasim me periudhën e verës. Ky përfundim është konform me rezultatet e anketës së bërë nga Universiteti Amerikan në Kosovë dhe Instituti i Roçesterit për Teknologji (AUK-RIT)² e cila anketë evidenton gjendjen jo të mirë të hapësirave të banimit kur vihet në pyetje izolimi termik. Nëse ndërlihen këta dy tregues (efekti i sezonalitetit dhe izolimi termik i dobët) me faktin se rreth 55 përqind e energjisë elektrike në Kosovë shfrytëzohet nga ekonomitë familjare atëherë lindë nevoja që këtij problem ti çasemi pak më ndryshe.

Në përputhje me rrethanat, qëllimi kryesor i këtij studimi është që të motivojë ndërhyrjen e politikës publike për të shqyrtuar mundësinë e optimizimit të përdorimit të energjisë në mënyrë që duke reduktuar faturat të ofrohet komoditet për familjet në rend të parë.

Ky studim është i ndarë në katër pjesë. Në pjesën e parë identifikohet gjendja aktuale e efijencës së energjisë në Kosovë, përpjekjet e qeverisë si dhe shpalosen në detaje masat që kërkohen për të arritur nivelin e izolimit termik deri në atë pikë ku investimi shpaguhet me efijencë. Më pas në pjesën e dytë shtjellohet ekonomiksi i efijencës i cili analizon në mënyrë të detajuar përfitimet potenciale që mund të reflektohen në bruto produktin vendor (BPV), nivelin e papunësisë si dhe standardin jetësor. Në fund është hartuar një plan i cili si pikë strategjike vë vetëdijësimin qytetar dhe lehtësirat që duhet të ofrojë qeveria përkrah masave ndëshkuese që duhet aplikuar për të parandaluar dështimin.

¹ Gashi K., Pozhegu D., Puka K. (2013), Hesapi i Rrymës, KOSID.

² Bowen B. H., Myers J. A., Myderizi A., Hasaj B., Halili B., (2013), Shpenzimet e energjisë elektrike në ekonomitë familjare në Kosovë: faktet dhe figurat, AUK-RIT.

1. Të kuptuarit e mungesës së masave të efijencës së energjisë në Kosovë

1.1. Fakte dhe shifra rreth Kosovës

Me efijencë duhet nënkuptuar masën optimale të energjisë së përdorur për kryerjen e një shërbimi të caktuar, ndërsa përmirësimi në efijencë do të thotë marrjen e më shumë nga ajo që ne përdorim. Pra, mund të themi se kemi qenë më efijentë nëse gjatë sezonës së dimrit kemi arritur të ngrohim objektin e banimit njëjtë sikurse vitin e kaluar por me shpenzime më të vogla duke mbajtur të gjithë faktorët e tjerë të pandryshuar – ceteris paribus (çmimi, kushtet klimatike, etj.).

Në një vend të varfër siç jemi edhe ne, gjithsecili është i interesuar padyshim të paguaj më pak për më të mirën. Në vitin 2011, një familje në Kosovë ka shpenzuar mesatarisht 1,210 euro për energji elektrike që përkthyer në bazë mujore i bie rreth 100 euro.³ Në anën tjetër të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2012, tregojnë se 30 përqind e shpenzimeve të ekonomisë familjare ndahen për shpenzime të banimit kategori kjo e cila mbulon edhe shpenzimet e energjisë elektrike.⁴ Prandaj përdorimi joefijent apo edhe ngritja e çmimit të energjisë elektrike do të varfërojnë shportën e qytetarëve të Kosovës edhe më tej.

Sipas statistikave të Bankës Botërore për vitin 2011, 29.7 përqind e qytetarëve të Kosovës jetojnë nën vijën kombëtare të varfërisë, ndërsa 10.2 përqind në varfëri të skajshme.⁵ Kur merret parasysh kufiri i varfërisë dha varfërisë së skajshme që është vetëm e vetëm 1.72 dhe 1.20 euro në ditë respektivisht, mund të konstatohet se gjendja është e mjerueshme dhe qeveria duhet të ketë kujdes të shtuar gjatë hartimit të politikave. Ajo që nuk duhet harruar është se kontribuesi më i madh i varfërisë është shkalla e lartë e papunësisë e cila në vitin 2009 kishte arritur në 45.4 përqind, ndërsa të dhënat e fundit të ASK-së për vitin 2012 të cilat janë të kontestuara fuqishëm pasi nuk përkojnë me ecuritë e zhvillimit ekonomik në vend raportojnë nivelin e papunësisë në shkallë prej 30.9 përqind, prej nga 55.3 përqind janë të rinjë të moshës prej 15-24 vjeç.⁶ Në anën tjetër gjendja nuk është e mirë edhe tek të punësuarit, kjo pasi intervali më i frekuentuar i pagës mujore neto është ndërmjet 301-400 euro (apo rreth 30 përqind e të anketuarve), ndërsa niveli 401 plus nuk shënon koncentrim as edhe prej 10 përqind të mostrës.⁷ Nga kjo nënkuptohet se mbi 50 përqind e të anketuarve pozicionohen në intervalin 1-300 euro të pagës mujore neto, ndërsa sipas rezultateve të AUK-RIT anketës, më se 42 përqind e familjeve urbane kanë nga një person të punësuar ndërsa 27 përqind me nga dy. Gjendja pritet të jetë më e rënduar në zonat rurale.

Të dhënat e lartpërmendura tregojnë që të ardhurat mesatare për shumicën dërrmuese të popullatës së Kosovës mbesin të pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet mujore ku ndër të tjera hyn edhe energjia elektrike fatura mujore e së cilës arrin deri në 100 euro në muaj. Për këtë arsye është jashtëzakonisht e rëndësishme që fatura mujore e energjisë elektrike të zvogëlohet/menaxhohet në mënyrë sa më të mirë

³ Gashi K., Pozhegu D., Puka K. (2013), Hesapi i Rrymës, KOSID.

⁴ Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2012, (2013), Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁵ Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në vitin 2011, (2013), Banka Botërore dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁶ Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore 2012 në Kosovë, (2013), Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁷ Ibid.

të mundshme dhe një nga metodat më efikase për të arritur këtë mbetet rritja e eficiencës së energjisë që duhet të jetë gjithashtu edhe qëllimi primar i qeverisë së Kosovës.

1.2. Konsumi i eficient i energjisë në Kosovë

Përmirësimi i eficiencës së energjisë është objektiv i vendeve edhe më të zhvilluara se Kosova dhe aspak i lehtë për tu arritur. Ani pse rezervat nacionale të linjitit llogariten të jenë të “pashterrshme”, sërish qeveria duhet të kujdeset që energjia të shpenzohet sa më mençur në mënyrë që të mirëmbahet furnizimi i qëndrueshëm dhe i sigurt dhe barra të mos bie mbi kurrizin e qytetarëve. Për të kuptuar gjendjen e tanishme të mos optimizimit apo joeficiencës së energjisë në Kosovë, do të çasemi një analize shumë të thjeshtë.

Së pari, ky studim targeton vetëm ekonominë familjare sepse janë ato që nga mos vetëdija dhe shprehitë joracionale dëmtojnë standardin vetanak jetësor duke lënë mënjanë bizneset pasi këto të fundit duhet që në mënyrë vetanake të racionalizojnë funksionin e inputeve në mënyrë që të maksimizojnë profitin. Prandaj është e udhës që qeveria të kthejë vëmendjen në masë të madhe tek ekonominë familjare.

Ngritja e eficiencës që nënkupton zvogëlimin e kërkesës për energji elektrike është objektiv jo shumë i lehtë për tu arritur. Përkundër kësaj, Kosova po përballlet me rritje të kërkesës për energji elektrike. Vetëm në tremujorin e dytë të vitit 2013 (TM2 3013) vendi ka konsumuar 857,7GW/h energji elektrike apo 3,3% më shumë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (TM2 2012), kjo sipas të dhënave të ASK-së.⁸ Sipas të njëjtit burim, nëse shpërndarja e energjisë kategorizohet në pesë klasë të konsumatorëve final del se amvisnia është konsumuesi më i madh i energjisë elektrike me pjesëmarrje prej 56.4 përqind apo 483.5 GW/h vetëm gjatë tremujorit të dytë të vitit 2013 (TM2 2013). Figura e mëposhtme tregon se nga TM1 2010 deri më TM2 2013 amvisnia është në mesatare konsumuesi më i lartë i energjisë elektrike.




Figura 1. Struktura e shpërndarjes së energjisë elektrike si mesatare e TM1 2010 – TM2 2013

⁸ Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2012, (2013), Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Më sipër shihet qartë domethënia e amvisnisë në sfidën përballë eficiencës. Me pjesëmarrje prej 56 përqind kjo kategori konsumatore lë pas kategorinë e shpenzuesve komercial (18 përqind), konsumatorët e privilegjar (220-110kV) (17 përqind), industrinë (6 përqind) dhe grupin e shpenzuesve të tjerë (3 përqind).

Përderisa në vendet më të zhvilluara zgjidhja e problemit të eficiencës së energjisë arrihet nëpërmjet politikave që prekin kryesisht bizneset, në Kosovë duhet të përpilohet një skenar që për fokus ka familjet. Prandaj qeveria duhet të jetë vigjilente gjatë adaptimit të ndonjë plani i cili edhe mund të ketë qenë shumë funksional në vendin burimor, por që mund edhe të mos i përshtatet Kosovës.

Figura më poshtë e cila në vazhdim ilustron ndryshimin e konsumit të energjisë nga kategoria e amvisnisë nga tremujori paraprak dhe tremujori i njëjtë i periudhës paraprake sjellë dy fakte interesante. Së pari, është tanimë e qartë se ekonomitë familjare shpenzojnë energji elektrike më shume gjatë periudhës së dimrit apo TM1 dhe TM4. Piku kishte arritur në vitin 2009 ndërsa gjatë viteve tjera shihet një stabilitet me rënie e ngritje të moderuara gjë që pamundëson çdo konkluzion mbi fillimin e zvogëlimit të efektit sezonal, një gjë e cila nuk pritet të ndodhë. Së dyti, është e rëndësishme të vlerësohet nëse në Kosovë ka arritur të kursehet energjia elektrike e kjo bëhet duke krahasuar tremujorët e njëjtë të periudhave të ndryshme. Mund të thuhet se prej vitit 2010 vetëm një herë është arritur të kursehet energjia dhe atë me një normë prej vetëm 1.44 përqind (TM1 2013 në krahasim me TM1 2012). Konsumi më i lartë është shënuar në TM1 2011, ndërsa dukuria ekspansioniste tenton në vazhdimësi të jetë më e butë duke qenë së fundmi edhe negative.




Figura 2. Ndryshimi i konsumit të energjisë nga amvisnia nga tremujori paraprak dhe tremujori i njëjtë i periudhës paraprake

Ndonëse një pasqyrim i tillë është mjaft i përshtatshëm për qëllime analitike, sërish duhet pasur kujdes gjatë interpretimit pasi rezultatet mund të jenë të ndikuara nga faktorët klimatikë dhe faktorët e tjerë determinues të konsumit të energjisë elektrike, thënë më mirë duhet pasur kujdes ndaj dimrave të butë dhe verave të forta. Tabela në vijim tregon se Kosova di të përballlet shpeshherë me dimra më të fortë se të zakonshmit, prandaj konsumi i energjisë elektrike shpeshherë priret të ketë sjellje presioniste gjatë muajve janar, shkurt dhe dhjetor.

Muaji	2009		2010		1011		2012	
	Max	Min	Max	Min	Max	Min	Max	Min
Janar	3.3	-3.8	4.4	2.5	4.3	-4.1	2.3	-5.2
Shkurt	5.5	-2.3	7.2	1.1	5.3	-4.2	0.0	-7.9
Mars	10.1	0.6	11.8	1.3	11.1	1.0	13.6	1.1
Prill	18.8	6.4	20.1	6.1	17.1	5.0	16.8	4.9
Maj	23.5	9.7	21.4	9.8	20.8	9.0	20.7	9.4
Qershor	24.3	12.7	25.3	12.9	25.4	12.8	28.5	13.7
Korrik	28.2	14.3	28.0	15.1	28.5	14.5	31.7	16.6
Gusht	28.6	14.8	30.4	15.0	30.4	14.0	31.8	15.0
Shtator	24.1	11.2	23.4	10.0	28.1	12.9	27.6	12.1
Tetor	16.5	6.1	14.7	5.5	16.5	3.6	21.6	7.5
Nëntor	13.6	2.4	15.8	5.1	10.5	-2.7	14.1	4.7
Dhjetor	7.8	0.7	6.7	-1.5	5.8	-1.7	3.0	-3.0

Tabela.1. Temperaturat e ajrit në Prishtinë, 2009 – 2012 . °C
Burimi: Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

Nëse ndërlidhim temperaturat maksimale dhe ato minimale me konsumin e energjisë elektrike mund të shihet qartazi pse gjatë TM1 2011 konsumi i energjisë elektrike nga kategoria e ekonomive familjare ishte për 12 përqind më i madh në krahasim me TM1 2010. E njëjta logjikë e karakterizon edhe TM1 2012 vetëm se shkalla e rritjes ishte më e vogël.

Për më tepër, në bazë të të dhënave të ASK-së mund të evidentojmë edhe rritjen e vazhdueshme të kërkesës për energji elektrike.




Figura 3. Konsumi i energjisë elektrike nga kategoria e amvisisë sipas viteve dhe përqindja e ndryshimit

Nga grafiku mund të shihet tendenca rritëse e kërkesës për energji elektrike nga ekonomitë familjare në Kosovë, ndonëse norma e rritjes është më e vogël gjatë vitit 2012 në krahasim me vitin paraprak. Në vitin 2012 norma e rritjes regjistrohet të jetë 3.79 përqind, normë kjo nën mesatare e cila arrin në 5.63 përqind (2010-2012). Nga ky grafik bëhet e qartë gjithashtu se konsumi i energjisë elektrike në vitin 2011 i cili u rrit për 7.19 përqind mund të jetë efekt i temperaturave më të ulëta të ajrit, duke vënë kështu sërish në pah efektin e dimrit të fortë në konsumin e energjisë.

Ky efekt shfaqet kryesisht si rezultat i izolimit të dobët termik të objekteve të banimit i cili është evident në Kosovë. Sipas anketës së bërë nga AUK-RIT del se izolimi termik i objekteve të banimit është në

gjendje të mjerueshme.⁹ Kjo pasi 63.7 përqind e shtëpive llogaritet të kenë çati të paizoluara, 52.9 përqind janë në mungesë të xhamave të dyfishtë ndërsa jo më pak se 69.5 përqind evidentohen të kenë mure të paizoluara. Po i njëjti burim tregon se në mesatare rreth 85 përqind e shtëpive urbane përdorin drurin si lëndë djegëse për ngrohje ndërsa vetëm 9 përqind energjinë elektrike. Sidoqoftë, kjo statistikë duhet të interpretohet me kujdes më të shtuar pasi mund të pasqyrojë informacion që destimulon përpjekjen dhe rëndësinë e eficiencës dhe si e tillë nuk duhet asesi të përdoret si argument dhe të nxjerret përfundimi se në masë të madhe objektet e banimit përdorin lëndët djegëse për ngrohje.




Figura 4. Rezultatet e anketës mbi izolimin termik të shtëpive të banimit

Sipas të dhënave të ASK-së rreth 71 përqind e objekteve të banimit të ekonomive familjare posedojnë nga tri (30 përqind), katër (26 përqind) dhe pesë (15 përqind) dhoma, ndërsa vetëm 3 përqind kanë nga një dhomë, përkundër faktit se 92 përqind e po këtyre shtëpive nuk kanë të instaluar ngrohjen qendrore.¹⁰ Duke pasur parasysh faktin që këto shtëpi nuk kanë të instaluar ngrohjen qendrore dhe koston e lartë të ngrohjes së secilës dhomë me dru, atëherë me gjasë të madhe mund të ndodhë që një pjesë e madhe e hapësirave të banimit përdorin metoda tjera të ngrohjes. Të dhënat statistikore diktojnë automatikisht përdorimin e energjisë elektrike kjo pasi konsumi gjatë periudhës së dimrit është shumëfish më i lartë në krahasim me periudhën e verës.

Për të bërë edhe më bindëse analizën, nga kombinimi i përqindjes së shtëpive që kanë të instaluar ngrohjen qendrore (8 përqind) dhe variacionit ditor të energjisë elektrike i cili arrin deri në 200 MW mund të nxjerrim një përfundim të asyeshëm se energjia elektrike përdoret si burim për ngrohje duke shtuar gjithashtu me siguri relativisht të lartë se presioni shfaqet gjatë orëve të mbrëmjes. Ky fakt substancializohet më tej, kur besohet se rreth 22 përqind e energjisë elektrike që injektohet në rrjet përdoret për qëllime të ngrohjes.¹¹

Si rrjedhojë, lirisht mund të përfundohet se energjia elektrike përdoret për ngrohje dhe atë në mënyrë joeficiente nga ekonomitë familjare kjo pasi objektet e banimit nuk kanë të instaluar ngrohjen qendrore e as nuk janë të izoluara mirë.

⁹ Bowen B. H., Myers J. A., Myderizi A., Hasaj B., Halili B., (2013), Shpenzimet e energjisë elektrike në ekonomitë familjare në Kosovë: faktet dhe figurat, AUK-RIT.

¹⁰ Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2012, (2013), Agjencia e Statistikave të Kosovës.

¹¹ Gashi K., Pozhegu D., Puka K. (2013), Hesapi i Rrymës, KOSID.

1.3. Rritja e efijencës, çfarë kërkon ajo?

Efijencia e energjisë së një shtëpie tregon se sa është e shtrenjtë për tu ngrohur ajo shtëpi, ndërsa aplikimi i masave përmirësuese do të ndihmojnë në reduktimin e shpenzimeve gjë që ndikon në mënyre absolute mirëqenien e familjeve. Për një familje me të ardhura të ulëta, kursimi financiar i gjeneruar nga instalimi i masave të efijencës së energjisë do të thotë se ata mund ta mbajnë me komoditet objektin e banimit të ngrohtë dhe në anën tjetër të ndjehen më të pasur. Duke rikujtuar nivelin e pagave në Kosovë një kursim mujor prej 20 euro përbën 7 përqind të pagës neto 300 euro, një raport mjaft inkurajues kursim/pagë.

Konsiderohet se përmirësimi i performancës termike është një nga mënyrat më efektive për të shkurtuar faturat në njërën anë dhe reduktuar emetimin e dioksidit të karbonit në anën tjetër.¹² Në fakt, Trusti i Kursimit të Energjisë në Angli e arsyeton izolimin e çatisë duke potencuar se vetëm nga ky investim është e mundshme të kursehen rreth 190 GBP në vit.¹³ Nëse luftohet ruajtja e 190 GBP në një vend ku paga mesatare javore gjatë muajit gusht 2013 është llogaritur të jetë 484 GBP, atëherë edhe kursimi i 10 apo 20 euro në muaj për qytetarët e Kosovës duhet të llogaritet si vlerë e konsiderueshme pasi niveli më i frekuentuar i pagës mujore mesatare është ai ndërmjet 300-400 euro.¹⁴ Sidoqoftë, përmirësimi i performancës termike duhet paraprirë me analizën e vështirësitë e ngrohjes së shtëpive në Kosovë dhe çfarë nevojitet për ti kthye ato në shtëpi kursimtare.

Figura e mëposhtme paraqet një vizualizim të zbërthyer të elementeve që ndikojnë në humbjen e ngrohtësisë në një shtëpi totalisht të paizoluar duke na lënë të kuptojmë se vetëm nga izolimi i mureve dhe çatisë humbet rreth 59 përqind e ngrohjes termike. Në kontrast dyert, dritaret, izolimi i dyshemesë së bashku me rrjedhjet tjera të ajrit përbëjnë 41 përqind të humbjeve.




Figura.5. Faktorët që ndikojnë në izolimin termik të një shtëpie shprehur në përqindje

¹² Clark, D., Chadwick, M., (2011), The Rough Guide to Community Energy, Rough Guides LTD.

¹³ Energy Saving Trust of United Kingdom, (2013), <http://www.energysavingtrust.org.uk>

¹⁴ Office for National Statistics; <http://www.ons.gov.uk>

Duke sjellë sërish në mendje faktin se në Kosovë më se 63.7 përqind e shtëpive llogaritet të kenë çati të paizoluara, 52.9 përqind janë në mungesë të xhamave të dyfishtë ndërsa jo më pak se 69.5 përqind kanë mure të paizoluara mund të vlerësojmë se në vend ka mjaft hapësirë për të ngitur nivelin e efijencës së energjisë elektrike duke konsideruar si hap të parë vetëdijësimin dhe motivimin e qytetarëve që të investojnë në izolimin e objekteve të banimit. Ndërsa me izolim duhet nënkuptuar instalimin e dritareve me xhama të dyfishtë si dhe izolimin e mureve dhe çative. Kësisoj, rruga më e drejtë për arritjen e efijencës së energjisë elektrike parashihet të jetë intervenimi në përfomancën termike shtëpi për shtëpi, dhe në këtë mënyrë do të preken dy çështje me rëndësi kombëtare, sikurse: optimizimi i përdorimit të energjisë elektrike dhe përmirësimi i mirëqenies së qytetarëve.

2. Benefitet e efijencës së energjisë

Efijenca e energjisë duhet parë si njëra nga shtyllat qendrore të përpjekjeve të qeverisë jo vetëm për të përmbushur qëllimin fundamental të dekarbonizimit të Kosovës duke tkurrur kërkesën për energji, por për faktin se ky investim është i ndërlidhur ngushtë me ecurinë e zhvillimit ekonomik dhe social.

Përfitimet e sigurta dhe ato të mundshme që sjell efijenca e energjisë sygjeron një listë mjaft të zgjatur apo thënë më ndryshe një vektor me magnitudë të lartë të benefiteve. Pasi vlerësohet të jenë më jetike për vendin tonë, ky studim fokusohet vetëm në tre tregues, siç janë: rritja ekonomike, papunësia edhe standardi i jetës.

2.1. Efijenca e energjisë si investim në rritjen ekonomike

Instalimi i masave të efijencës së energjisë kërkon investim që ka potencial të nxisë rritjen ekonomike, përderisa në klimën e tanishme rritja ekonomike është sfida më e madhe e shumë qeverieve duke mos përjashtuar as Kosovën nga ai mes.

Pasi në pjesën e parë të këtij studimi është konstatuar se izolimi i dobët i objekteve të banimit e bën përdorimin e energjisë joeficient, në vazhdim do të elaborohet specifikisht efekti i investimit në izolim në sjelljen e BPV-së.

Siç edhe mund të shihet nga figura.5. për të përmirësuar kapacitetin termik të një shtëpie duhet të investohet në dyer e dritare si dhe në izolimin e mureve, dyshemesë dhe çatisë. Meqë vetë aksioni për rritje të efijencës ndërlidhet me rritjen e kërkesës së produkteve ndërtimore në tregun vendor, duhet të nënkuptohet se potenciali për rritje ekonomike do të eksploatohet me gjasë të madhe. Por, duhet bërë me dije se rritja e kërkesës për të mira e shërbime nuk është e ndërlidhur gjithmonë dhe automatikisht me rritjen ekonomike, e kjo mund të ndodhë në rast se politikat qeverisëse nuk favorizojnë prodhuesit vendorë dhe nuk krijojnë parakushte për zhvillimin e konkurrencës së lirë në tregun lokal.

Përderisa është e arsyeshme të ndërtohen pritje optimiste në lidhje me efijencën e energjisë dhe rritjen ekonomike, nuk mund të diskutohet mbi qëndrueshmërinë e rritjes dhe përmasat që ajo mund të ketë në afat më të gjatë kohor sepse çdo kalkulim i cili ndikohet në masë të madhe nga racionalizimi i sjelljes konsumatore bëhet shumë kompleks, e sidomos kur konsumator është familja e jo biznesi sikurse në rastin tonë.

Përveç rritjes ekonomike, nëse arrihet nivel i lartë i efijencës së energjisë një efekt shumë i dëshiruar mund të reflektohet gjithashtu edhe në pozitën tregtare neto të energjisë. Sipas statistikave të ASK-së që nga viti 2002 e deri më sot vendi ynë vazhdon të ketë pozitë të thelluar deficitare. Pasi me rritje të efijencës nënkuptohet kursim i energjisë së përdorur, Kosova mund të performojë më mirë lehtësisht duke tkurrur importin e rritur eksportin në anën tjetër.

2.2. Punëzënia si benefit socioekonomik

Në kohën e papunësisë së lartë dhe të qëndrueshme, krijimi i vendeve të reja të punës është bërë padyshim temë e ngrohtë diskutimi. Në të shumtën e rasteve investimet sjellin me vete nevojën për më shumë kapital njerëzor. Përderisa në vendet më të zhvilluara siç është për shembull rasti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës bëhet matja e numrit të vendeve të reja të punës që gjenerohen si rezultat i investimit të 1 milion USD në një industri specifike, tek ne dhe vendet tjera në tranzicion një gjë e tillë është e pamundur të kalkuklohet pasi edhe vetë tregu i punës është i degjeneruar.

Pasi izolimi termik i objekteve të banimit është identifikuar si masë kyçe për të trajtuar problemin e joefijencës, pritët që sektori i ndërtimtarisë do të jetë përfituesi më i madh direkt. Prandaj është e pritshme që ofruesit e të mirave dhe shërbimeve që ndërlidhen me procesin e izolimit termik të jenë më aktivë, e kjo nënkupton nevojën e shtuar për salduesit e shtëpive, prodhuesit e dyerve dhe dritareve dhe produkteve të tjera të nevojshme.

Përveç përfituesve direkt, është e mundshme të krijohen edhe vende të reja indirekte të punës pasi kursimi i energjisë i cili ngritë nivelin e të ardhurave të disponueshme do të nxisë kërkesën për produkte tjera e me këtë rast pritët krijimi i vendeve të reja të punës. Ndonëse numri i vendeve indirekte të punës mund të jetë për disa herë më i vogël, këto vende sërish mund të cilësohen si më të qëndrueshme kjo pasi procesi i izolimit nuk është i përjetshëm. Në anën tjetër të flitet për efektin neto në papunësi është e lehtë pasi pozita tregtare deficitare e Kosovës lë të besohet se sektori i energjisë nuk do të zvogëlojë aktivitetin prodhues si pasojë e ngritjes së efijencës dhe se shkurtimi i vendeve të punës në këtë sektor besohet se do të ndodhë vetëm nëse ndonjë projekt inovativ mbështet njëkohësisht me projektin e izolimit termik.

Nëse analizohet punësimi sipas aktivitetit ekonomik del se në Kosovë gjatë vitit 2012 kishim 29 mijë persona apo rreth 9.5 përqind të fuqisë punëtore që përfaqësonin kategorinë e ndërtimtarisë. Prej tyre vetëm 1 përqind ishin femra çka nënkupton se përfituesit më të mëdhenj direkt do të jenë meshkujt. Veç kësaj, izolimi termik i shtëpive duhet të konsiderohet si aktivitet i cili nuk kërkon ndonjë shkallë të lartë të ekspertizës apo përgatitjes profesionale. Sipas të dhënave të ASK-së, 1.84 përqind e të papunëve në Kosovë janë të pashkolluar, 30.06 me shkollim fillor dhe 57.55 përqind me shkollim të mesëm.¹⁵ Prandaj është e pritshme që implementimi i masës së efijencës së energjisë nuk do të përballet me ndonjë mungesë të fuqisë së duhur punëtore.

¹⁵ Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore 2012 në Kosovë, (2013), Agjencia e Statistikave të Kosovës.

2.3. Efektet në standardin e jetës

Instalimi i masave të efijencës së energjisë është kryekput i lidhur me nivelin e të ardhurave të disponueshme, të ardhura që mund të përdoren për të përmbushur nevojat konsumatore me produkte e shërbime të tjera përkundër faturës mujore të energjisë. Sikurse në rastin e ndërhyrjes në izolim termik edhe këtu kemi të bëjmë me rritje të kërkesës për të mira e shërbime prandaj ekonomia priret të përfitojë pasi bizneset duke u përballur me kërkesën në rritje mund të zvogëlojnë shpenzimet operacionale e të rrisin produktivitetin si pasojë.

Për të arritur rezultate reale në standardin e jetës, sado të papërfillshme që duken të jenë këto rezultate politikbërësit duhet të mposhtin njëkohësisht edhe efektin e tërheqjes i cili shpeshherë di të shkatërrojë gjithë përpjekjen.

Efekti i tërheqjes¹⁶ shfaqet atëherë kur pas implemetimit të masave të efijencës nuk realizohet potenciali i plotë i ruatjes së energjisë dhe praktikisht janë dy fenomene që e shpjegojnë këtë dukuri. E para, për familjet me të ardhura të ulëta të cilat janë përballur me temperatura më të ulët se ato normale izolimi termik do të thotë se këto familje vetëm se do të ngrohen më shumë me energjinë e njëjtë të shpenzuar ose edhe do të kenë tendencë të rrisin shpenzimet pasi fillojnë të akomodohen me temperatura më të larta. Dhe e dyta, energjia e kursyer mund të shfrytëzohet nga ndonjë pajisje elektronike e cila është bërë e përballueshme nga niveli më i lartë i të ardhurave të disponueshme.

Veç kësaj, instalimi i duhur i masave të efijencës mund të ketë ndikim edhe në shëndetin publik pasi zbutja e papunësisë dhe ngritja e të ardhurave të disponueshme mund të ndikojnë në princip kualitetin e jetës. Kur dihet se në Kosovë vetë, 2.5 përqind e energjisë elektrike prodhohet në hidrocentrale, dekarbonizimi që vie si rezultat i konsumit/prodhimit më të ulët të energjisë është benefit që nuk ka vlerë matëse.¹⁷

3. Plani për implementimin e efijencës së energjisë

3.1. Fuqizimi i vetëdijes qytetare

Problemi i joefijencës së energjisë nuk do të lindte sikur shoqëria si tërësi të përbënte pakon e konsumatorëve të optimizimit racional, sepse atëherë askush nuk do të humbiste me vetëdije përfitimet që sjellë përdorimi i drejtë i energjisë.

Duke pasur parasyshë rrethanat nëpër të cilat jemi venitur tash e sa dekada dhe duke e gjetur veten për momentin në hendekun e thellë të varfërisë është shumë e lehtë dhe tejet e drejtë të supozohet se ne si shoqëri në përgjithësi jemi “naive” dhe jo për tu lavdëruar duke qëndruar si e tillë shumë larg racionalizimit optimal, apo zgjedhjes më të mirë. Padiskutim një sjellje e tillë diktohet shpeshherë nga kufizimet financiare e jo rrallëherë nga shprehitë e këqia dhe asimetria informative. Si pasojë, duhet nënkuptuar se secila strategji, projekt apo plan i veprimit që përdorë konsumatorët (ekonomitë familjare) si ndërmjetës për zbatim duhet të nisë me një kampanjë e cila ka për qëllim primar

¹⁶ Anglisht: Rebound effect.

¹⁷ Bilanci i Energjisë TM3-2013, (2013), Agjencia e Statistikave të Kosovës.

vetëdijësimin qytetar, në të kundërtën funksionalizimi i suksesshëm vihet në rrezik edhe sikur projekti të jetë i hartuar në mënyrën më të mirë të mundshme.

Ekzistojnë tri forma potenciale të vendimmarrjes që paraprijnë një sjellje të dështuar lidhur me investimin në eficiencën e energjisë. E ato janë: teoria perspektivë, ajo e racionaliteti të kufizuar dhe vendimmarrja deduktive.¹⁸ Duke u bazuar në rrethanat, format më reale të vendimmarrjes në Kosovë janë ajo e racionalitetit të kufizuar dhe vendimmarrjes deduktive, pasi teoria perspektivë është më e sofistikur duke kërkuar ndërtimin e pritjeve në lidhje me përfitimet dhe humbjet eventuale. Racionaliteti i kufizuar nuk e mohon faktin se konsumatorët janë racional por përkundër e arsyeton sjelljen e tyre duke përdorur si argument bazë mungesën e informacionit të plotë, mungesë kjo e cila shkakton edhe shmangien nga zgjedhja më e duhur. Ndërsa forma e vendimmarrjes deduktive zhvillohet në atë mënyrë ku konsumatori i lë si të mundshme vetëm optionet për të cilat ka një eksperiencë paraprake duke mos iu vënë fare veshin zgjedhjeve tjera ndoshta edhe më inovative. Prandaj rekomandohet që vetëdijësimi qytetar të përdoret si pikë fillestare sepse mosfunksionalizimi si rezultat i dështimit të sjelljes është i dhimbshëm dhe asesi i arsyeshëm kur vihen në pyetje vlerat e larta të mjeteve financiare (kosto financiare) që do të përdoren për eficiencën e energjisë, në rastin tonë investimi në izolimin termik të objekteve të banimit.

Ajo që duhet të bëhet e qartë është se konsumatorët nuk do të arrijnë kurrë pikën perfekte të racionalitetit, as edhe në rastin kur atyre iu ofrohet informacioni më i plotë. Vetëdijësimi qytetar arrihet atëherë kur forma e komunikimit është më e besueshme, e shpeshtë dhe e përcjellë me punë e vepra. Komunikimi i shpeshtë dhe kredibil do të zhdukë asimetrinë informative dhe mund të shërbejë si udhërrëfyes përballë vendimit nëse duhet apo jo të investohet në izolimin termik të shtëpisë.

Në një formë më të përmblodhur mund të thuhet se ajo çfarë qeveria duhet të ofrojë është edukimi i vazhdueshëm cilësor dhe informimi i qytetarëve, e kjo është çështje që kërkon një reagim të politikës me urgjencë.

3.2. Si mund ti ndihmojmë qytetarët ti bëjnë shtëpitë e tyre më eficiente ndaj përdorimit të energjisë

Për të motivuar të tjerët të bëjnë diçka që është mbi të gjitha në të mirën e një grupi shoqëror patjetër duhet të veprohet në dy drejtime, së pari duhet ofruar ndihmë për të ushtruar mundësinë e ndëshkimit në rast nevojë më pastaj. Këto dy mekanizma duhet të aplikohen në mënyrë të pandashme, të vazhdueshme dhe në baza jo preferenciale nëse me të vërtetë dëshirohet të arrihet një objektiv i caktuar.

Deri më tani, secili taksapagues në Kosovë është dëmtuar shumë rëndë kur me paranë publike është subvencionuar Korporata Energjetike e Kosovës (KEK). Vetëm gjatë periudhës 2009-2011 qeveria ka alokuar nga buxheti hiç më pak se 146 milion euro dhe kjo shpërndarje e mjeteve padyshim është përcjellë me kosto relativisht të lartë oportune pasi të gjithë ne qytetarët e Kosovës për të subvencionuar KEK-un kemi hequr dorë nga kthimi i projekteve të tjera që në esencë edhe mund të kenë qenë më prioritare për ne, si për shembull: investimi në shëndetësi dhe arsim. Duke iu përkujtuar anomalinë e korrupsionit që dita ditës po e arrin pikun mund të përfundohet se keqmenaxhimi i këtyre mjeteve i cili mund të ketë ndodhur mesiguri përbën një kosto shtesë. Përkundër gjithë kësaj, nga kosto totale nuk duhet përjashtuar as edhe luhatjet më të vogla të çmimit të energjisë të cilat i janë faturuar konsumatorit

¹⁸ Anglisht: prospect theory, bounded rationality dhe heuristic decisionmaking

final me e pa të drejtë. Në anën tjetër, në mungesë të një plani të frytshëm apo thënë më mirë në mungesë të objektivit që ndërlidhet me eficiencën e energjisë qeveria ka aplikuar si masë ndëshkuese akcizën për poçët inkadashent. Si rrjedhojë, është jashtëzakonisht i nevojshëm ndërtimi i një politike që ka për qëllim stimulimin e izolimit të objekteve të banimit dhe në anën tjetër planin për parandalimin e dështimit i cili bazohet kryesisht në masa ndëshkuese.

3.2.1. Lehtësirat financiare për eficiencën e energjisë

Pasi Kosova është në përpjekje të vazhdueshme për të adresuar problemin e eficiencës së energjisë, çdo politikë duhet të vë në shërbim kapacitetet e gjertanishme për të shmangur ndonjë përzjerje të mundshme kompetencash apo lojën e dyfishtë. Prandaj duke vlerësuar si jo funksionale përpjekjet e deritanishme ky studim synon që të mobilizojë të gjitha insitucionet që sipas ligjit për eficiencën e energjisë në fuqi (Ligji Nr. 04/L016) ngarkohen me përgjegjësi specifike.

Secili projekt madhor për tu realizuar me sukses ka nevojë për tre partner: financuesin, udhëheqësin dhe monitoruesin. Për nevojat e këtij projekti si sponzorues kryesor por jo edhe i vetëm do të përdoret Ministria për Zhvillim Ekonomik (MZhE), si udhëheqës Agjencia e Kosovës për Eficiencën e Energjisë (AKEE) ndërsa rolin e monitoruesit do ta ketë Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë (KMKE), të gjitha këto organe që dalin paraprakisht nga ligji në fuqi.

Si nevojë fillestare e projektit të eficiencës së energjisë parashihet të jetë identifikimi i rajoneve ku boshllëku i eficiencës është më i madh, prandaj auditimi i energjisë është proces i paevitueshëm. Pasi të kemi një pasqyrë më të qartë të gjendjes ekzistuese duhet me mençuri të targetohen ato rajone, lagje, rrugë e rrugica që garantojnë efikasitet të nivelit më të lartë. Më shkurt, duhet të targetohen ato rajone ku shtëpitë janë më të paizoluara, sepse pikërisht ato rajone janë çelësi i suksesit. Sërish, për të qenë edhe më konkret fokusin duhet vënë në grupe të veçanta familjare apo duhet funksionuar në bazë selektive. Për disa arsye të cilat edhe do të shpjegohen më poshtë ky studim e sheh si mjaft të përshtatshme formën selektive të veprimit, kjo pasi: 1) papunësia ka karakter regjional, 2) aty ku papunësia është më e theksuar kursimet familjare janë të nivelit zero, dhe 3) pabarazia e të ardhurave në Kosovë është mjaft e theksuar, figurativisht edhe mund të thuhet se shtresa e mesme është në zhdukje e sipër. Me fjalë të tjera, duhet të ndihmohen ato ekonomi familjare të cilat janë më të prekura nga papunësia, kjo pasi këto familje priren të kenë më pak të hyra mujore në formë të pagës prandaj edhe duhet të konsiderohen si më në nevojë.

Si pasojë, duke parë se jo të gjithë janë në nevojë dhe në mënyrë që ti ofrohet ndihmë kategorisë më të ndjeshme është e arsyeshme që ekonomitë familjare të ndahen në tri grupe e për tu arritur një gjë e tillë fillimisht duhet të përcaktohen kufijtë apo pragjet të cilat gjatë kalkulimit do të duhej të kenë parasyshë faktorë të shumtë socio ekonomik, si psh: niveli i të hyrave mujore për familje, anëtarët që ndjekin procesin shkollor, shëndetin e përgjithshëm familjar, etj. Përveç faktorëve ekonomik e social duhet evidentuar edhe gjendja e objekteve të banimit në mënyrë që të vlerësohen nevojat dhe kosto financiare e projektit. Në grupin e parë do të përfshiheshin ato familje të cilat nga buxheti familjar nuk janë në gjendje ti bashkohen projektit nacional për eficiencën e energjisë, dhe si i tillë ky grup paraqet barrën më të madhe financiare. Në grupin e dytë do të duhej të përfshiheshin ato familje që deri diku mund të përmbushin nevojën për izolimin termik të shtëpive dhe si i tillë duke shfrytëzuar një stimulim më modest ky grup bart me vete barrë mesatare, ndërsa grupi i tretë i cili numëron familjet që financiarisht janë më stabile paraqesin vetëm barrën e të hyrave buxhetore. Kjo formë e kategorizimit familjar do

të ndihmonte më pas procesin e targetimit dhe financimit dhe ofron një siguri më të madhe për përmbushjen e objektivit.

Për mbështetjen e projektit të eficiencës së energjisë lindë nevoja për themelimin e Fondit Nacional për Eficiencën e Energjisë (FNEE). Meqë ligji për eficiencën e energjisë (Ligji Nr. 04/L016) e rregullon vetëm çështjen e përdorimit të energjisë në sektorin publik, themelimi i këtij fondi me karakter privat mund të cilësohet si i paligjshëm. Prandaj rekomandohet fuqishëm që ligji në fuqi të ndryshohet dhe të përshtatet në atë formë që siguron përfshirjen edhe të sektorit privat. Ky fond është i paraparë të menaxhohet nga AKEE dhe të monitorohet në baza më të shpeshta periodike nga KMKE. Ky fond duhet të mbështetet nga Qeveria e Kosovës çoftë nga të hyrat e rregullta buxhetore apo nga kreditë për qëllime të veçanta që mbështeten lehtësisht nga partnerët ndërkombëtarë si dhe duhet bërë përpjekje serioze për tërheqjen e donacioneve nga Komisioni Evropian dhe gjithë organizmat tjerë që çështjen e eficiencës së energjisë e trajtojnë me kujdes të shtuar. Për më shumë në këtë fond duhet të derdhen edhe mjetet që gjenerohen nga akciza e aplikuar për poçët joeficient.

Parase të fillohet implementimi i projektit, qeveria duhet të krijojë kushte të përshtatshme për të rritur konkurrencën e tregut për produktet që identifikohen si të nevojshme për izolim më të mirë të shtëpive. Që këtë shihet si akt i nevojshëm subvencionimi i prodhuesve vendor në mënyrë që të stimulohet importi, ndërsa për produktet e tjera që nuk prodhohen në vend duhet të përjashtohet masa doganare e aplikuar prej 10 përqind.

Për grupin e parë të ekonomive familjare, ndihma duhet të jetë e plotë dhe pa kthim. Kjo nënkupton se izolimi termik i shtëpive i cili nënkupton ndërrimin e dritareve, izolimin e mureve dhe çatisë do të bëhet në llogari të shtetit dhe qytetarët nuk do të ngarkohen me ndonjë kosto eventuale. Meqë ky grup paraqet pjesën më të madhe të kostos, projekti mund të ndahet në faza duke u investuar së pari në çati e dritare e më vonë në izolimin e mureve.

Për grupin e dytë kërkohet bashkëpunim në mes të FNEE dhe sektorit bankar. FNEE duhet të krijojë një marrëveshje me bankat komerciale për lëshimin e kredive me normë të ulët të interesit dhe afat më të gjatë të maturimit. Me këtë rast FNEE duhet të marrë rolin e garantuesit dhe të paguaj interesin në emër të kredimarrësit. Për të mbajtur procesin nën kontroll, banka duhet të kontrollojë dhe parandalojë ndryshimin e qëllimit të kredisë së lëshuar dhe të raportojë rregullisht tek FNEE.

Së fundi, përpos lehtësirave doganore që mund të reflektohen në çmimin e produkteve në treg për grupin e tretë nuk parashihet ndonjë ndihmë direkte nga fondi. Prandaj siç edhe është cekur më lart ky grup paraqet vetëm barrë të të hyrave buxhetore.

Duhet bërë me dije se projekti për eficiencën e energjisë nuk kërkohet të implementohet sot për sot por brenda një periudhe më të gjatë kohore, prandaj duhet pranuar me optimizëm edhe përkundër kostos shumë të lartë që mund të mbart me vete.

3.2.2. Opcionet për parandalimin e sjelljes së dështuar konsumatore

Pasi të jenë ofruar të gjitha kushtet për tejkalimin e problemit të joeficiencës që përfshijnë informimin dhe lehtësirat tjera përcjellëse sipas kategorive përkatëse, qeveria me shumë të drejtë mund të aplikojë masa ndëshkuese për ato familje që ushtrojnë sjellje të paarsyeshme. Patjetër që duhet ndëshkuar ata individë që megjithë izolimin e shtëpisë dhe informacionit që kanë në dispozicion nuk arrijnë të

zvogëlojnë shpenzimet mujore të energjisë. Aplikimi i masave ndëshkuese na bën optimistë se ekonomitë familjare do të nxiteshin në përkrahje të planit nacional për eficiencën e energjisë.

Prandaj, kjo analizë sygjeron si masa ndëshkuese dhe mjaft të lehta për tu aplikuar tatimin në pronë dhe dizajnimin e disa skemave të çmimit të energjisë. Është e natyrshme se mundësitë janë gjithnjë të shumta prandaj politikëbërësit nuk duhet limituar aktivitetin vetëm në këto dy pika, përkundër duhet bërë përpjekje në vazhdimësi për të gjetur forma tjera më të përshtatshme dhe inovative.

Në mënyrë që të shtyhen qytetarët të izolojnë objektet e tyre të banimit është e drejtë të aplikohen norma më diferenciale të tatimit në pronë. Që këtu lindë nevoja për bashkëpunim të thellë ndërmjet qeverisjes së nivelit lokal dhe asaj qendrore. Niveli lokal duhet të bëjë evidentimin dhe rishikimin e vazhdueshëm të gjendjes së shtëpive dhe duhet të aplikojë norma më të larta të tatimit për ato shtëpi që nuk plotësojnë disa nga standardet minimale të cilat duhet përcaktuar paraprakisht. Tatimi në pronë duhet të jetë i karakterit progresiv dhe kjo nënkupton mos aplikimin e vetëm dy normave të tatimit në pronë (izoluar, paizoluar) por më shumë, kjo pasi një shtëpi mund të ketë dritare shume të vjetra por kulm të izoluar dhe një tjetër mund të ketë mure të izoluara mirë e dritare tejet të vjetra prandaj në krahasim me një shtëpi totalisht të paizoluar duhet aplikuar një normë më të përafërt me atë që aplikohet në kushte normale.

Në anën tjetër, si shtytës mjaft efikas mund të parashihet çmimi i energjisë. Ekonomitë familjare sipas numrit të anëtarëve duhet të kategorizohen në pako të veçanta, e në bazë të këtij kategorizimi duhet përcaktuar pragu i mjaftueshëm i shpenzimeve për secilën familje. Për çdo tejkallim apo thënë më mirë për atë familje e cila me shpenzimet e saj ka tejkaluar prapun e mjaftueshmërisë duhet aplikuar tarifë më të lartë të energjisë. Në këtë mënyrë ekonomitë familjare do të përdornin më me kujdes energjinë e kjo nënkupton vetë eficiencën.

Përfundime

Duke parë Kosovën që po përballet me një kërkesë gjithnjë në rritje të energjisë nga ekonomitë familjare, qëllimi i këtij studimi është që në përfundim të rrethanat të motivojnë ndërhyrjen e politikës publike për të shqyrtuar mundësinë e optimizimit të përdorimit të energjisë në mënyrë që duke reduktuar faturat të ofrohet komoditet për familjet në rend të parë.

Ky studim evidenton dukurinë e sezonalitetit e cila nënkupton se kërkesa për energji nga ekonomitë familjare është dukshëm më e madhe gjatë sezonës së dimrit dhe se sjellja e kërkesës është relative me fortësinë e dimrit. Më pas, duke përdorur të dhënat ekzistente mbi gjendjen e izolimit termik të objekteve të banimit në nivel nacional përfundohet se joeficienca apo përdorimi jo i drejtë i energjisë elektrike është pasojë e izolimit të dobët termik, ndërsa me izolim të dobët identifikohet nevoja për instalimin e dritareve me xhama të dyfishtë si dhe izolimin e mureve dhe çative.

Në një formë më të shkëputur elaborohen potencialet që mund të zërthej instalimi i masave të eficiencës në rritjen ekonomike, papunësi dhe standardin e jetës. Përveç rritjes ekonomike, duke arritur

një nivel më të lartë të efijencës së energjisë rrjedhimisht besohet se do të ketë një efekt pozitiv edhe në pozitën tregtare neto të energjisë gjithashtu.

Më pas, nën supozimin se shoqëria kosovare është në përgjithësi jo racionale ndërtohet plani i implementimit për efijencën e energjisë, plan i cili si fazë fillestare dhe shumë të nevojshme e rekomandon fuqizimin e vetëdijes qytetare. Karakteristikë tejet e veçantë e planit të veprimit është çasja dydrejtimëshe e cila nëpërmjet dy mekanizmave totalisht të kundërt me njëri tjetrin ka për qëllim të motivojë ekonominë familjare ti bashkohen planit nacional për efijencë të energjisë. Duhet bërë me dije se këto dy mekanizma është e paraparë të aplikohen në mënyrë të pandashme, të vazhdueshme dhe në baza jo preferenciale apo selektive në mënyrë që secila ekonomi familjare të gëzojë ndihmën financiare apo të ndëshkohet me të drejtë.

Duke parë auditimin e energjisë si një proces të paevitueshëm, ky plan ndër të tjera e sheh si të arsyeshëm veprimin në bazë selektive e kjo nënkupton kategorizimin e ekonomive familjare në tri grupe. Në grupin e parë rekomandohet përfshirja e atyre familjeve të cilat nga buxheti vetanak nuk mund të izolojnë objektet e banimit duke paraqitur kështu barrën më të madhe financiare të projektit. Në grupin e dytë do të duhej të përfshiheshin ato familje që deri diku mund të përmbushin nevojën për izolimin termik të shtëpive dhe si i tillë duke shfrytëzuar një stimulim më modest ky grup bart me vete barrë mesatare, ndërsa grupi i tretë i cili numëron familjet që financiarisht janë më stabile paraqesin vetëm barrën e të hyrave buxhetore.

Në anën tjetër, për të realizuar projektin e efijencës së energjisë lindë nevoja për themelimin e Fondit Nacional për Efijencën e Energjisë (FNEE). Meqë ligji në fuqi për efijencën e energjisë e rregullon vetëm çështjen e përdorimit të energjisë në sektorin publik, themelimi i këtij fondi me karakter privat mund të cilësohet si i paligjshëm. Prandaj rekomandohet fuqishëm që ligji në fuqi të ndryshohet dhe të përshtatet në atë formë që siguron përfshirjen edhe të sektorit privat.

Pasi të jenë ofruar të gjitha kushtet për tejkalimin e problemit të joefijencës që përfshijnë informimin dhe lehtësirat tjera përcjellëse sipas kategorive përkatëse, qeveria me shumë të drejtë mund të aplikojë masa ndëshkuese për ato familje që ushtrojnë sjellje të paarsyeshme. Si masa ndëshkuese dhe mjaft të lehta për tu aplikuar kjo analizë sygjeron dizajnimin e disa skemave të çmimit të energjisë si dhe aplikimin e normës diferenciale të tatimit në pronë. Është e natyrshme se mundësitë janë gjithnjë të shumta prandaj politikëbërësit nuk duhet limituar aktivitetin e tyre vetëm në këto dy pika, përkundër duhet bërë përpjekje në vazhdimësi për të gjetur forma tjera më të përshtatshme dhe inovative për promovimin dhe zhvillimin e efijencës së energjisë.